

KREJT SHOKËT E MI (pjesa 2)

Fuqia e Durimit

Ne jemi në pjesën e dytë të Serisë, "*Krejt Shokët e Mi*". Bibla thotë që nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm. Ne jemi krijuar për komunitet, jo për vetmi. Do të theksojmë miqësitë për tri arsye:

Miqësitë tregojnë lumturinë tënde.

Ato mund të jenë burim gëzimi ose burim dhimbjesh. Një miqësi mund të të bëjë të ndihesh shumë keq ose shumë i vlerësuar. Psikologët thonë që shumica e problemeve emocionale i kanë rrënjët në miqësitë e këqija. Shumica e vetëvrasjeve ndodhin për shkak të shoqërisë së keqe që ka personi. Është e vërtetë që miqësitë e tua tregojnë lumturinë tënde.

Miqësitë përcaktojnë suksesin tënd.

Nëse rrethi i shokëve të tu nuk punon, as ti nuk do e vlerësosh punën. Nëse ata janë punëtorë dhe e vlerësojnë shkollën, edhe ti do të vlerësosh shkollën dhe punën.

Miqësitë forcojnë karakterin.

Ku do jesh ti pas disa vitesh ka shumë shanse të përcaktohet nga dy gjëra: gjërat që mendon (librat që lexon, videot që shikon) dhe me kë rri.

Bibla thotë tek

1 e Korintasve 15:33b "*Shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira.*"

Shoqëritë e këqija dëmtojnë karakterin tënd. Si i bie shqip? "Më thuaj me kë rri, të të them se kush je." Shoqëria po hyn në zonën e "kuqe", si tek makina, shigjeta e karburantit ka hyrë në të kuqe, kur i ke shokët copë-copë. Shumë pak njerëz dinë si të reagojnë ndaj të tjerëve. Dhe s'ka shumë modele të mira për të ndjekur.

Herën e shkuar pamë që: Dashuria është baza e çdo shoqërie. Ne të gjithë e dimë këtë gjë. Por problemi është që shumica e njerëzve e keqkuptojnë dashurinë. Perëndia i ka kushtuar vëmendje të madhe dashurisë, aq sa një kapitull i tërë në Bibël flet vetëm për të. Ai thotë: "Dashuria është kështu, por nuk është kështu..."

Tani do të shohim pjesën e parë se çfarë është dashuria tek:

1 Korintasve 13:4 "*Dashuria është e durueshme...*"

Perëndia thotë që kur fillon të kesh shoqëri të mira, së pari duhet DURIM. Nga e di Perëndia një gjë të tillë? Ai e di sepse ka disa mijëra vite përvojë duke u

marrë me njerëzit. Atij i është dashur shumë durim. Kuptimi original në greqisht i kësaj fjale do të thotë: “Do shumë kohë që të ziejë.”

A e ke dëgjuar shprehjen “mos i fol atij se është gjaknxehtë, s’është në terezi, është me nerva”? S’po përdorim ato shprehjet, si “nuk është mirë nga trutë, ka ikur fare nga mendorja...” Nëse do që të merresh me njerëzit, duhet të jesh njeri që “do shumë kohë që të ziejë.”

Dashuria është e duruar. Sa herë që tregohesh i duruar, ti po tregohesh i dashur. Sa herë që jam i duruar me familjen time, aq herë po iu jap dashuri.

Përse Durimi Është i Rëndësishëm te Shoqëritë dhe Marrëdhëniet?

Përse, ndër të gjitha gjërat që mund të kishte thënë Perëndia për të filluar një shoqëri, thotë të fillosh me durimin? Pse qenka kaq e rëndësishme? Ja ta shohim:

1. Sepse të gjithë jemi të ndryshëm

1 Korintasve 12:6b *“...Perëndia i cili i bën (vepron) të gjitha gjërat në të gjithë.”*

Ai thotë që të gjithë jemi origjinalë, nuk ka dy njerëz njëloj. Nëse ti ke motër/vëlla e ke të lehtë ta kuptosh. E njëjta familje, krejt të ndryshëm. Perëndia të ka krijuar ty në një formë unike.

Janë pesë faktorë që të bëjnë të ndryshëm nga të tjerët. Dhe je i tillë sepse të tillë të ka krijuar Perëndia.

* Dhuntitë frymërore—Aftësitë e veçanta, që t’i ka dhënë Perëndia pasi i ke besuar Jezusit, ato dhunti që t’i ka dhënë për t’i shërbyer Atij dhe për të krijuar dhe pasur një miqësi të fortë me Të.

* Pasioni—zemra jote, çfarë ke më shumë për zemër, me pasion. Ne të gjithë motivohemi ndryshe. Të gjithë kemi interesa të ndryshëm. Gjëra që të motivojnë ty nuk më motivojnë mua dhe e kundërta. Të gjithë kemi rrahje të ndryshme zemre, nuk janë dy njësoj.

* Aftësitë—Ne të gjithë kemi aftësi të ndryshme, aftësitë që burojnë natyrshëm nga ne. Ka këtu që janë hidraulikë, bukëpjekës, elektrikistë, muzikantë, ekonomistë, bojaxhi, usta....

* Personaliteti—Secili prej nesh ka personalitete të ndryshme dhe vlerësojmë gjëra të ndryshme. Ka njerëz të mbyllur si tipa, dhe njerëz të hapur, njerëz që u pëlqen rutina, njerëz që duan variacion, të qetë, me ton të lartë / të ulët...

* Eksperiencat (Përvojat)—Të gjithë kemi prejardhje të ndryshme, shkollim të ndryshëm, nevoja të ndryshme, kemi përvoja të ndryshme në familje, shkollë, punë.

Për shkak të këtyre 5 gjërave—mënyra sesi Perëndia të ka formuar ty—nuk ka dy persona në botë që t'i kenë të pesta njëlloj, s'ka njeri në të gjithë botën si ty. Ti je shumë i ndryshëm nga çdo njeri tjetër dhe je shumë kompleks.

(shënim: merr një gotë të mbushur deri në gjysmë me ujë)

Provë: Tek kjo gotë, çfarë shikon ti, që është gjysmë me ujë apo është gjysmë pa ujë?

Ne të gjithë kemi perspektiva të ndryshme. Po të jenë 5 veta dhe të shohin të njëjtin aksident në rrugë, të pestë kanë parë gjëra të ndryshme. Sepse jemi të ndryshëm.

Provë: Një diplomë shkolle me 5 dhjeta dhe 1 nëntë. Letërsi 10, Matematikë 10, Histori 10, Fizikë 10, Biologji 9, Gjeografi 10.

Nëse kjo do të ishte diploma jote si do ndiheshe ti? Po jap unë pesë sugjerime:

- 1) Sa do kënaqen prindërit me mua.
- 2) Do më thonë, si more 9 Biologji, lëndët e vështira i ke 10?
- 3) Kur ta shohi mami, kush e di çfarë do më japi.
- 4) Sa inat që s'i mora të gjitha 10-ta!
- 5) Me siguri unë jam i pari i klasës me këto nota.

Ne jemi të gjithë ndryshe. Dhe kjo është një Arsye e Madhe për të qenë të duruar...

2. Sepse Ndryshimet Tona Krijojnë Keqkuptime

Për shkak se jemi të ndryshëm, kjo krijon keqkuptime. Ka shumë raste që ne s'e kuptojmë njëri-tjetrin. S'e kupton dot tjetrin: *"Nga doli ky me këtë ide?"*

1 e Korintasve 2:11a *"Sepse cili nga njerëzit, pra, njeh gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të?"*

Askush nuk e kupton gruan time/ose fëmijët e mi... Nëse ti punon, e di pronarin, drejtorin e shkollës... as atë se kupton dot herë pas here! A i ke përdorur një nga këto shprehjet e mëposhtme këto 30 ditët e fundit?

"Nuk po e marr vesh pse sillet ky kështu, ore se çfarë ka ky.

Ajo nuk më kupton mua, kot merrem me të.

Ai nuk është këtu fare more vëlla, kush e di se ku po kullot. Ja ke fut kot fare, pa pikë lidhje.

Si ka mundësi që mendon kështu për mua kjo?

Prindërit e mi nuk janë ne vete.

Pse duhet të them 100 herë të njëjtën gjë?

Pse nuk ma the më para?

Pse nxelesh kaq kollaj, se kuptoj?”

Sa nga këto ke përdorur ti?

Për shkak se njerëzit janë të ndryshëm, krijohen keqkuptime.

1 Thesalonikasve 5:14b "... Të jeni të duruar me të gjithë."

Si mund të jem i duruar me të gjithë? Kur s'ke durim vijnë keqkuptimet dhe nga keqkuptimet vijnë 4 hamendësime.

Hamendësojmë që:

1. Të njëjtat fjalë kanë të njëjtin kuptim për të gjithë.

Jo. Dikush mund ta kuptojë krejtësisht ndryshe atë që po thua. Dy persona dëgjojnë ose lexojnë diçka që ke shkruar ti dhe njëri e kupton ndryshe, tjetri ndryshe.

2. Ka vetëm një mënyrë për ti parë gjëra.

Nuk është e vërtetë. Madje dhe i njëjti person ka momente që e shikon të njëjtën gjë një herë ndryshe, një herë ndryshe.

3. Mënyra sesi i shikoj unë gjërat është mënyra e duhur.

Nuk do kishim probleme nëse ti dhe unë do kishim të njëjtën mendje. Por, e kundërta, "Unë ia thashë shumë qartë, ajo s'kishte kuptuar gjë fare, më shumë ishte ngatërruar se sqaruar. Unë i shikoj gjërat me syrin logjik, ai tjetri hamendëson. Kështu si ta thashë unë ty ka shumë kuptim, por ti ke ngelur i hutuar, dhe s'po kap gjë fare."

4. E di pse e ke thënë ti këtë, ku do të dalësh.

Jo, nuk është e vërtetë. Njerëzit e ndryshëm motivohen ndryshe. Ka raste që unë nuk kuptoj veten time pse i bëj ca gjëra—çfarë motivi kam—jo më të kuptoj motivet e të tjerëve. Nuk mund ta kuptosh se çfarë synimi apo motivi ka dikush kur bën diçka.

Perëndia thotë, "*Të jeni të duruar me të gjithë.*" Kjo është e pamundur. Është e thjeshtë kur e thua, është ideale kur e mendon, por a ka njeri që e zbaton?

Por si ta zbatoj?

Sepse është e urdhëruar nga Perëndia, nuk është "Po deshe," e ka thënë Ai. Ai nuk po thotë "Po të jap një ide, mundohu të jesh i duruar me të gjithë, ti bëj tënden, po s'deshi ai/ajo, s'ka gjë." JO. Ai thotë "*zbatoje, Ji i duruar me të gjithë.*"

Perëndia kurrë nuk na thotë diçka për të bërë pa na dhënë hapat e zbatimit.

Si Mund Të Jesh Më I Duruar Me Njerëzit?

1. Kujtohu Sesa i Duruar Është Perëndia Me Ty

Ty s'do të të duhet të tregohesh më i duruar me dikë, sesa ka qenë vetë Perëndia me ty.

1 Timoteut 1:16 (Pali) *"Por prandaj u mëshirova, që Jezu Krishti të tregojë më përpara në mua gjithë zemërgjerësinë (durimin e tij)..."*

Në vargjet më sipër, Pali thotë, "Perëndia më zgjodhi mua. Unë isha një vrasës." Ai mori pjesë në vrasjen e Stefanit. Ai ishte shumë fanatik në besimin e tij të vjetër. Dhe ai tha, "Perëndia ma ndryshoi drejtimin e jetës për të më treguar mua sesa e madhe është zemërgjerësia, durimi i tij ndaj meje."

Mbaj mend që, herën tjetër, kur do t'i thuash dikujt, "Luaj duart", "Sa i papjekur që je", "S'u rrite ndonjë herë ti." Kujtohu që ka patur shumë raste që Perëndia ka dashur të të thotë ty të njëjtën gjë. "Pse nuk nuk po futet në rrugë ky njeri, pse nuk po bën atë që thotë? Pse nuk po piqet? Pse nuk po i pastrohet ajo gojë nga ai fjalor? Etj. Etj." Ai ka qenë i duruar me ne.

Romakëve 15:7a *"Pranoni njëri-tjetrin, sikurse edhe Krishti na pranoi... ."*

Arsyeja pse duhet t'i pranoj të tjerët siç janë është sepse Perëndia më ka pranuar mua. Arsyeja pse unë duhet të kem durim me njerëzit e tjerë është sepse Perëndia ka patur durim me mua. Arsyeja pse unë duhet të përpiqem për t'ia kaluar mirë me njerëzit e tjerë është sepse Perëndia do që t'ia kalojë mirë me mua. Pra, pika e fillimit është: Kujtohu sa i duruar ka qenë Perëndia me ty.

2. Mëso Duke Dëgjuar

Fjalët e Urta 19:11 *"Mençuria (mirëkuptimi) e bën njeriun të mos rrëmbehet shpejt (e zbut) nga zemërimi..."*

Fjalët e Urta 14:29 *"Kush është i ngadalshëm në zemërim është shumë i matur..."*

Nëse ti do që të mësohesh sesi të jesh i duruar, më shumë i duruar, çelësi është tek matura. Dhe sa më i mençur, i ditur, të jesh, aq më i matur je. Dhe sa më shumë i matur që tregohesh dhe e kupton personin tjetër, aq më i duruar ke për të qenë me ta.

Sepse po nuk i kuptove, nuk ke për të qenë i duruar me ta. Nëse nuk i kupton, nuk do të kesh pikën e dëshirës për të patur shoqëri me ta, sepse shoqëria e ka bazën tek të njohurit e të kuptuarit e personit tjetër.

Nëse ti nuk më kupton mua ose unë ty, çfarë shoqërie mund të kemi ne të dy? Vetëm, “Ç’kemi, si je, shëndet.” Aty është fillimi. Pa njohje, s’ka shoqëri. Keqkuptimi e shkatërron shoqërinë.

Të kuptuarit vjen nga urtësia—lexo në Bibël—shiko se çfarë thotë Perëndia për të.

Një nga nevojat më të mëdha të njeriut është ta kuptojnë të tjerët.

Pol Toner, një fizikant Zvicerian ka thënë “*Askush në këtë botë nuk mund të zhvillohet tamam ose të ketë një jetë të plotë nëse nuk ndihet që e ka kuptuar të paktën një njeri tjetër. Askush nuk e njeh dot veten e tij duke i bërë analiza vetes apo thjesht duke mbajtur një ditar personal. Pra, gjendet në dialogun që ka me njerëzit.*” Sepse në këtë mënyrë kupton kush je dhe se si të ka krijuar Perëndia. Prandaj na duhen shoqëritë.

Por si mund t’i kuptoj unë njerëzit ndaj të cilëve jam i paduruar? Nëse dua t’i kuptoj më shumë, duhet të jem më i duruar me ta. Si mund t’i kuptoj më mirë njerëzit që janë në botën time?

Duke i dëgjuar ata, duke u dhënë vëmendje.

Fjalët e Urta 18:13 “*Kush jep përgjigje për një çështje para se ta ketë dëgjuar, tregon marrëzinë e tij për turp të vet.*”

Turp e faqja e zezë për kë përgjigjet para se të dëgjojë!

Është shumë e thjeshtë, apo jo?! Mos e vlerëso se çfarë bën dikush, pse e ka bërë, pa e dëgjuar atë person deri në fund. A i ke thënë dikujt ose të ka thënë dikush “*Lërë, lërë e kuptova, mos vazhdo më, lërë...*” Perëndia të ka dhënë dy veshë dhe një gojë—kjo do të thotë të dëgjosh dyfishin e asaj që thua.

Po lexoja diçka për një lloj bretkose, që bën atë zërin e fortë nëpër pellgje natën. Perëndia i ka krijuar këto bretkosa me një muskul që dërgon dridhje në trurin e tyre dhe kjo i bën ata të mos e dëgjojnë zërin e fortë që nxjerrin. Nuk e dëgjojnë veten e tyre. Dridhja e muskulit anulon dëgjimin. Sa inat që nuk e dëgjojnë atë zërin e bukur që kanë.

Çfarë mësojmë nga kjo:

Është shumë e vështirë të dëgjosh kur e ke gojën e hapur! Një djalë i ri shkoi tek Sokrati (filozofi Grek) që të bëhej nxënës i tij, si të bëhej orator.

Në takimin e parë me të, djaloshi filloi të fliste, e fliste pa ndalim, pa pushim, që ta impresiononte ate. Sokrati i vuri dorën tek goja dhe i tha: *“Mos, i hape punë vetes, do të më paguash dyfish.”*

Nxënësi e pyeti: “Pse?”

Ai iu përgjigj: “Së pari, do të mësoj shkencën sesi ta mbash gojën mbyllur dhe së dyti do të mësoj shkencën si ta përdorësh në momentin e duhur.”

Çfarë note do t’i vësh vetes tënde si dëgjues, nga 1-10? A dëgjon më shumë apo flet më shumë? Shumica nga ne mendojnë që janë dëgjues të mirë, por sa me vëmendje dëgjon?

Po lexoja për një djalë mistrec që donte të provonte që njerëzit në dasma nuk e kanë mendjen fare, nuk të dëgjojnë. Ai shkoi në dasmë dhe duke iu buzëqeshur njerëzve e iu thoshte, *“E kam lëshuar qenin.”* Ai tha: Të gjithë buzëqeshnin dhe i përgjigjeshin, *“Faleminderit, shumë faleminderit.”*

Nga një kërkim doli që vetëm 7% e asaj që thua, komunikohet me fjalë. 43% komunikohet nga mënyra sesi e thua—volumi i zërit, uljet, ngritjet, toni. Kurse 50% që ngelet, komunikohet nga shprehjet e fytyrës, lëvizjet e duarve ose ndryshe quhet gjuha e trupit.

Prandaj kur je në telefon ti ke komunikuar 50% të bisedës, nuk ka efekt. Sepse nuk e shikon atë tjetrin që po të flet sesi komunikon me trup. Dhe prandaj ka shumë keqkuptime me të shkruar, mesazhe, emaile, sepse tjetri ka kuptuar vetëm 7% të asaj që po mundohesh të thuash. Kjo do të thotë që sytë janë po aq të rëndësishëm sa veshët. A të kanë thënë ndonjëherë prindërit, ose ata që janë të martuar, bashkëshorti/tja: *“Pse nuk më shikon në sy kur të flas. Hiqi sytë nga celulari ose TV kur flet me mua.”* Ai person e di, që sytë janë po aq të rëndësishëm sa veshët kur bisedon sepse vetëm 7% e komunikimit vjen nga fjalët.

A do të mësojmë që të bëhemi dëgjues të mirë?

3. Toleroni Njëri-Tjetrin

Secili nga ne ka ditë që s’është në terezi. Herë pas herë të gjithë nuk jemi në formë. Varet, dikush e ka në një orë të ditës, dikush të javës, dikush të muajit. Të gjithë kemi ditë të vështira, sepse kështu është jeta. Ka momente që ti nuk do që të të afrohet dikush më shumë se një metër. Nuk do që të të prekë njeri. Dhe ja ku thotë Bibla: Durojeni, tolerojeni njëri-tjetrin.

Efesianëve 4:2b *“Me durim, duke e duruar (toleruar) njëri-tjetrin në dashuri.”*

Fjalët e Urta 12:16b *“...Njeriu i matur e fsheh turpin.”*

Ne të gjithë kemi ditë të vështira dhe të gjithë jemi pak të çakorduar. Duke qenë vetë ashtu, ti toleron edhe të tjerët. Sepse e di që të gjithë kanë ditë të ngarkuara.

4. Bëj Për të Tjerët Atë Që Do që të Bëjnë Për Ty.

Rregulli i Artë. Dhe vjen nga Mateu.

Mateu 7:12a *"Gjithçka, që ju dëshironi t'ju bëjnë njerëzit, ua bëni edhe ju atyre..."*

Ky varg i vetëm, mund të largojë shumë përplasje, sherre. Është shumë i lehtë për t'u kuptuar, por është shumë i vështirë për t'u vënë në praktikë. Nëse do të zbatohet, familjet do të ishin më të shëndetshme, lidhjet më të forta.

Trajtoi të tjerët ashtu siç do që të të trajtojnë ty. E thënë ndryshe...

Filipianëve 2:4-5 *"Mos mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve. Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin."*

Kushtoi vëmendje nevojës së njerëzve të tjerë. Shiko. Dëgjo. Zbullo se ku kanë nevojë.

A mund të më thuash cilat janë **TRE** nevojat më urgjente të shokut tënd, personit që po del, të fejuarit, burrit—gruas? Jo të tuat, ai/ajo duhet t'i dijë të tuat, ti duhet të dish të atij/asaj. Po tre ëndrrat, a e di çfarë viti është në shkollë, kur i ka provimet, sa ka marrë, a e di ku e ka shtëpinë, çfarë pune bën, kur ka përvjetorin e martesës, ditëlindjen e fëmijëve...

Disa herë përfshihemi aq shumë me veten tonë, në atë botën tonë të vogël, sa që harrojmë fare, ose s' duam t'ia dimë se çfarë ndodh rreth nesh.

Bibla thotë, *"Mendoni për interesat e të tjerëve, nevojat e të tjerëve."*

Nëse të bëhet vonë për nevojtarët, ke për ta parë nevojën. Merre në konsideratë.

A po ndihmon dikë? Sigurisht që ti ke nevojë për ndihmë vetë. Por a mbyllet aty, kur ti merr një lloj ndihme, a mendon për dikë?

Për mua, kur marr një dhuratë mundohem që 30-50% të dhuratës ta ndaj me të tjerët.

A është e lehtë ti mendosh gjërat nga pikëpamja e dikujt tjetër, se çfarë nevojë ka ai? Jo, nuk është e lehtë, as normale, as nuk të buron natyrshëm. Kërkon përpjekje. Kërkohet ndihma e Perëndisë. Zakonisht ne i shohim me syrin tonë, "Po të jem mirë unë, të gjithë mirë janë, po të mos jem mirë unë, s' dua t'ia di për të tjerët". Mendo për të tjerët. Ky është çelësi për shoqëri të forta.

"Kini në ju po atë ndjenjë që ishte tek Jezu Krishti". Ky është sekreti i vërtetë i durimit. Nuk buron natyrshëm durimi ndaj njerëzve të tjerë. Por duhet fuqia e Perëndisë në jetën tënde.

Këtë javë, tek puna, shkolla, në autobus, në dyqan, ke për të takuar dikë që mund të të acarojë, i lodhshëm, apo ta shpif. Perëndia thotë të jemi të duruar me këdo. Si mund të jesh i duruar me këdo? Duke patur sjelljen e Jezusit.

Vetëm duke patur Jezu Krishtin në jetën tënde ti mund t'ia trajtosh të tjerët në mënyrën siç i trajtoi Ai. Ky është sekreti i durimit.

Kjo është fuqia e durimit! Në vend që të thuash, "Perëndi, ndryshoi ata se më acarojnë mua, po ma nxjinë jetën mua," jo, lutu ndryshe: "Perëndi, fillo të punosh tek unë dhe në sjelljen time që t'ia dua siç do i doje ti." Në momentin që Ai të ndryshon ty, do të fillojë të ndryshojnë edhe të tjerët.

Le të lutemi.